

**VENDIM**  
**Nr. 730, datë 24.10.2012**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 16.8.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E  
KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË  
STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN  
SHKOLLOR 2012 - 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 25 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 545, datë 16.8.2012 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2.3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje: “Nxënësve të klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, që nuk kanë përfituar bursë me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, mbështetur në kërkesën e drejtorisë arsimore rajonale u akordohet/miratohet bursë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.”.

b) Në fund të pikës 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale për nxënësit e klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi “Termohidraulikë”, për vitin e ri akademik 2012 - 2013, të japë 456 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) muaj bursë. Analitikisht, numri i nxënësve, muaj/ditë bursë kuotë ushqimore, niveli/masa e bursës jepen sipas pasqyrës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit profesional dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Nr.	Emri i shkollës	DAR/ZA	Numri i bursave që do të transferohen	Totali i nxënësve që	Periudha	Njësia e qeverisjes vendore	Gjithsej muaj bursa	Ditë praktike/ për tu	Kuota ushqimore në lekë	Totali në lekë/kuotë ushqimore
-----	-----------------	--------	---------------------------------------	----------------------	----------	-----------------------------	---------------------	-----------------------	-------------------------	--------------------------------

			Nr. i nxënësve të regjist. në klasën e 13*	Nga këta aktualisht përfitojnë bursë*	përfitojnë bursë		pritiëse	Për vitin akademik 2012-2013	trajtuar me kuotë ushqimore burse	ditë	
					A			B	C	D	E=AxCxD
1	Shkolla Mek. Profesionale	Lushnjë	16	0	16	4-29 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	16	25	206	82,400
2	“Beqir Çela”	Durrës	20	2	18	1 - 26 prill 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	18	26	206	96,408
3	“Salih Ceka”	Elbasan	44	2+ ½	41.5	26 nëntor 2012 - 1 shkurt 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	83	55	206	470,195
4	“Karl Gega”	Tiranë	39	10	29	1 tetor 23 nëntor 2012 (2 muaj)	Bashkia Durrës	58	54	206	322,596
			39	10	29	26 nëntor-21 dhjetor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	29	25	206	149,350
5	“Rakip Kryeziu”	Fier	15	3	12	29 tetor - 23 nëntor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	12	27	206	66,744
			15	3	12	1 prill-24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	24	54	206	133,488
6	Industriale “Pavarësia”	Vlorë	23	1	22	7 janar - 1 shkurt 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	22	24	206	108,768
			23	1	22	4 shkurt - 29 mars 2013 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	44	53	206	240,196
7	Shkolla e Ndërtimit	Korçë	22	0	22	4 shkurt - 1 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	22	25	206	113,300
			22	0	22	1 prill - 24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	44	54	206	244,728
8	“Kolë Idromeno”	Shkodër	13	0	13	29 tetor - 23 nëntor 2012 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	13	25	206	66,950
			13	0	13	26 nëntor 2012 - 1 shkurt 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	26	54	206	144,612
9	“Stiliano Bandilli”	Berat	11	1	10	1 tetor-23 nëntor 2012 (2 muaj)	Bashkia Lushnjë	20	54	206	111,240
			11	1	10	4 shkurt-1 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	10	24	206	49,440
10	“Thoma Papapano”	Gjirokastrë	9	4	5	4-29 mars 2013 (1 muaj)	Bashkia Elbasan	5	25	206	25,750
			9	4	5	1 prill - 24 maj 2013 (2 muaj)	Bashkia Durrës	10	54	206	55,620
					<b>301.5</b>	<b>Kosto totale e parashikuar në lekë</b>		<b>456</b>	<b>658</b>	<b>206</b>	<b>2,481,785</b>